



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE  
SANKSIONEVE

Data: 11 Maj 2021

Nr: 56

VENDIM

**PËR KTHIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 32, PARAQITUR NË KQZ NË DATËN  
07.05.2021 PËR PLOTËSIMIN E ELEMENTEVE TË FORMËS, TË PËRCAKTUARA NË  
NENIN 126 TË KODIT ZGJEDHOR**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 11.05.2021, me pjesëmarrjen e:

Ledio BRAHO	-	Relator
Elvin LAKO	-	Anëtar
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Illirjan RUSMALI	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

**KËRKUES:**

Tasim Mehmeti, kandidat për deputet i listës shumemërore i subjektit zgjedhor Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK) për qarkun Vlorë;

**OBJEKTI:**

Shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 32 të z. Tasim Mehmeti, kandidat për deputet i listës shumemërore i subjektit zgjedhor Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK) me objekt "Kundërshtimin e vendimit nr. 345, datë 04.05.2021 "Për Miratimin e Tabelës Përmbledhëse për Rezultatit e votimit në zonën zgjedhore, qarku Vlorë për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputet në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021 të KSHZ".



**BAZA LIGJORE:** Nenet 21, 124, 126, 129, 130 dhe 131 të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenet 17 dhe 18 të vendimit të Komisionit Rregullator nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

### V Ë R E N:

Ankuesi Tasim Mehmeti, kandidat për deputet i listës shumëpartiake të subjektit zgjedhor Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK) për qarkun Vlorë, ka depozituar pranë KQZ-së kërkesë ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 32 regj, datë 07.05.2021.

Në mbledhjen e datës 11.05.2021, ora 09:30, pas relatimit të z. Ledio Braho dhe diskutimit të z. Mehmeti, u konstatua se kërkesa ankimore nr. 32 nuk i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126 pasi më konkretisht, së pari nuk është e qartë se cili subjekt zgjedhor ankohet (neni 126, pika 1, shkronja “a”) pasi në fletën e dytë të kërkesës ankimore ka nënshkruar si ankues z. Tasim Mehmeti, ndërkohë që në fletën e tretë ka nënshkruar z. Kostaq Papa si përfaqësues i Partisë së Emigracionit Shqiptar, parti kjo që me vendimin nr. 117, datë 08.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e koalicionit “Aleanca Bashkimi Popullor - Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK) për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 prill 2021”, në zbatim të neneve 65 dhe 66 të K.Zgjedhor, është regjistruar si pjesëtare e këtij koalicioni, së dyti nuk referohet vendimi që ankimohet (neni 126 pika shkronja “b”) si dhe ankuesi nuk ka depozituar së bashku më ankimin edhe vendimin e plotë, ndaj të cilit ushtron ankimin (neni 126, pika 2).

Në bazë të nenit 129, pika 1, të K.Zgjedhor, KAS për çdo kërkesë ankimore të regjistruar bën verifikimin e ekzistencës së elementeve të formës sipas nenit 126 të K.Zgjedhor dhe të elementeve të përcaktuara në nenin 130 të po këtij kodi.

Në kushtet kur kërkesa ankimore objekt i kësaj procedure të plotësimit të formës dhe përmbajtjes nuk i plotëson kushtet e shkronjave “a” dhe “b” të pikës 1, të nenit 126, të K.Zgjedhor, kjo kërkesë duhet të kthehet për plotësimin e elementeve të formës, të përcaktuara si më sipër.



## PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 126 dhe 129 pika 1 dhe pika 3 shkronja “c” të K.Zgjedhor dhe të nenit 17, pika 2, dhe pika 3, shkronja “c” të vendimit të Komisionit Rregullator nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” të Komisionit Rregullator,

## V E N D O S I:

1. Kthimin e kërkesës ankimore nr. 32, datë 07.05.2021, për plotësimin e elementeve të formës, të përcaktuara në nenin 126 të K.Zgjedhor të paraqitur nga Tasim Mehmeti, kandidat për deputet i listës shumemërore i subjektit zgjedhor Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK) për qarkun Vlorë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

**Ledio BRAHO - Relator**

**Elvin LAKO - Anëtar**

**Elvis ÇEFA - Anëtar**

**Ilirjan RUSMALI - Anëtar**

**Koli BELE - Anëtar**

